

**VENDIM**  
**Nr. 9, datë 10.1.2020**

**PËR CAKTIMIN E NJËSIVE ZBATUESE PËR HATIMIN E PLANEVE TË  
DETYRUARA VENDORE DHE FINANCIMIN E TYRE NGA FONDI PËR  
RINDËRTIMIN, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Caktimin si njësi zbatuese për hartimin e planeve të detyruara vendore të:
  - a) Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), për hartimin e planeve të detyruara vendore për 9 bashki: Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirëditë, Shijak, Vorë;
  - b) Bashkisë Tiranë për hartimin e planit të detyruar vendor për Bashkinë e Tiranës.
2. Efekti financiar, prej 262 297 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekësh, përballohet nga zëri “Fondi për rindërtimin”, i miratuar në buxhetin e vitit 2020 dhe, përkatësisht:
  - a) Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, i shtohet fondi prej 137 420 000 (njëqind e tridhjetë e shtatë milionë e katërqind e njëzet mijë) lekësh, për hartimin e planeve të detyruara vendore të bashkive, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij vendimi;
  - b) Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, i shtohet fondi prej 124 877 000 (njëqind e njëzet e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekësh, për hartimin e planit të detyruar vendor të saj, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij vendimi.
3. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave, në zbatim të këtij vendimi, kthehen në buxhetin e fondit për rindërtimin.
4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**